VENDIM
Nr. 195, datë 26.11.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "*ENERGY SUPPLY* - AL" SHPK, NR. 309, SERIA T11/T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 6, DATË 2.2.2011 DHE RINOVUAR ME VENDIMIN NR. 122, DATË 14.10.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 8, 9, 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 26.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 122/5 prot., datë 18.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë "*Energy Supply* - AL" sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "*Energy Supply* - AL" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1185 prot., datë 10.11.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nr. 309, seria T11/T15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 122, datë 14.10.2015.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në datën 20.1.2010, është regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKB).

- Shoqëria "*Energy Supply* - AL" sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 309, seria T11/T15, të tregtimit të energjisë elektrike, që prej datës 2.2.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 6, rinovuar së fundmi me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 14.10.2015, për pesë vjet të tjera, deri në datën 3.2.2021.

- Në bazë të nenit 16, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë "*Energy Supply* - AL" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germat: "a", "b") është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

-Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d"), është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

- Neni 16, pika 1, germa "d" (Vërtetim për kryerjen e pagesës së regjistrimit për aplikim dhe kërkesë për njohje në llogari të ERE-s, sipas aneksit A të kësaj rregullore). Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore

- Neni 9, pika 2:

- germa "d" (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Plotësuar pjesërisht;

- konstatohet mungesa e vërtetimeve të gjykatës dhe prokurorisë për përfaqësuesin me prokurë të shoqërisë. Shoqërisë do t'i kërkohet depozitimi i tyre në zbatim të nenit 7, pika 2 të rregullores. Po ashtu vihet re edhe mungesa e vërtetimit të organeve të drejtësisë për administratoren (nga vendi i saj i origjinës), për të cilat do t'i kërkohet shoqërisë depozitimi në ERE.

- Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3:

- germa "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Pa plotësuar. Duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin mbështetës.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 4.8:

- germat: "a"/"d" (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gwh/sipas viteve). Pa plotësuar. Shoqëria duhet të depozitojë në vijim sasitë e kërkuara të energjisë të parashikuara për t'u tregtuar;

- germa "b" (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin. Vetëm deklarata nuk përmbush këtë kërkesë të rregullores;

- germa "c" (Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur). Pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur kontratat e tregtimit të energjisë elektrike që mund të ketë pasur më parë, por duhet të depozitojë informacion lidhur me to.

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 309, seria T11/T15, të shoqërisë "*Energy Supply* - AL" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit nr. 6, datë 2.2.2011 dhe rinovuar me vendimin e Bordit nr. 122, datë 14.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 4.2.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti